

VENDIM
Nr. 16, datë 3.4.2013

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS TEPELENË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a. ujësjellës Tepelenë me:
 - drejtues ligjor, Arben Kaçorri;
 - drejtues teknik, Klodian Gumeni.
2. Operatori sh.a. U Tepelenë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
 - Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e mbulimit të këtij operatori është:
 - Bashkitë Tepelenë, Memaliaj;
 - Komunat: Qesarat, Kurvelesh, Krahës, Buz, Lopës, Luftinjë, Qendër Memaliaj, Qendër Tepelenë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri më 2.4.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi